



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:019734

Datë: 25.11.2024

Numri i dokumentit: 06500331

C-III.-12-1193

*Paditës:*

**M ( O ) S – Fshati B, Lipjan**  
*Përfaqësuar nga Av.Rr R nga Lipjani.*

*Kundër*

*E paditura:*

**NSH “Kooperativa Bujqësore Kosova” Lipjan - Njësia punuese “Shpeztaria” përfaqësuar nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit–AKP, lagja Lakrishte “Dritan Hoxha” nr. 55, Prishtinë.**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Hajrie Shala gjyqtare kryesuese, Manushe Karaqi dhe Sylejman Shumolli gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të dt.25 nëntor 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit M O nga Lipjani, me të cilën ka kërkuar që e paditura Agjencioni Kosovar i Privatizimit t’ia liroi nga njerëzit dhe sendet dhe t’ia dorëzoi në posedim parcelën kadastrale nr P-.. me sipërfaqe të përgjithëshme prej 0,31.45 ha në vendin e quajtur “Branesh“ Z.K. Dobratin, Komuna e Graqanicës, e nëse kjo nuk është e mundur atëherë e paditura t’ia dorëzoi në posedim dhe pronësi paditësit një palujtshmëri tjetër e cila i përgjigjet karakteristikave gjeodezike, pozitës dhe sipërfaqes me parcelën kontestuese, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit .
- II. Paditësi nuk ngarkohet me taksë shtesë.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me dt.23.07.2012 paditësi ka ushtruar padi pranë Dhomës së Posaçme për vërtetim të pronësisë për pronën e cila ishte në emër të babait të tij O S – parcela kadastrale nr. P-.. vendin e quajtur “ B” ZK D, Komuna e Graçanicës e me sipërfaqe të përgjithshme prej 0,31.45ha. Në padi ka theksuar se paraardhësi i tij ishte ishte qiradhënës, pasi që kishte lidhur kontratë për qiranë me Kooperativën Bujqësore “Poloprivreda” Lipjan – si qiramarrës, me objekt i kontratës ka qenë dhënia me qira e paluajtshmërisë së përmendur. Këtë pronë në emër të qiramarrjes Kooperativa Bujqësore e ka shfrytëzuar deri në vitin 1995 duke e bërë pjesë të kompleksit të Fermës së Pulave. Meqenëse, e paditura edhe më tutje e shfrytëzon këtë pronë paditësi disa herë ka ushtruar kërkesa për lirim të paluajtshmërisë dhe propozim të dorëzimit në posedim të pronës por, kjo nuk ka ndodhë andaj, paditësi është obliguar që të kërkojë në mënyrë ligjore kthimin e pronës. Po ashtu, paditësi ka propozuar edhe caktimin e masës së përkohshme për të ndaluar tjetërsimin e pronës nga AKP-ja pasi që kooperativa bujqësore është në proces të privatizimit. Në mbështetje të padisë paditësi ka bashkëngjitur: Certifikatën e pronësisë, Certifikatën e lindjes së paditësit O S dhe Certifikatën e vdekjes së tij, Kontratën për qiranë me numër . e dt.. dhe Kërkesën e dt.10.06.2010 drejtuar AKP-se. Kurse, me dt.22.02.2013, përmes parashtresës ka dorëzuar “ortofoton” e parcelës .. dhe tërë pjesën e ZK në D..

Me dt.13.03.2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së ka marrë aktvendim me të cilin ka refuzuar kërkesën e paditësit për lëshimin e urdhërit paraprak. Ndaj këtij vendimi pala paditëse ka paraqitur ankesë ndërsa, me aktvendimin e 13.08.2015 të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së është aprovuar si e bazuar ankesa e ankuesit duke anuluar vendimin e Kolegjit të Specializuar për ta miratuar kërkesën e paditësit për lëshimin e masës së përkohshme.

Me dt.05.10.2015, e paditura AKP ka paraqitur mbrojtjen në padi në të cilën ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe pretendimet e theksuara në padi duke konsideruar se e njëjta është në kundërshtim me ligjin dhe me legjitimitetin aktiv në procedurë. Tutje ka shtuar se prona kadastrale për të cilën pretendon paditësi është eksproprijuar me qëllim të ndërtimit të Fermës së Pulave ashtu që këtë e vërteton dhe regjistri mbi eksproprijimin ku shihet se shpronësimi është bërë sipas ligjit dhe kompensimi për pronën e eksproprijuar është kryer. Krejt në fund ka propozuar që padia të hedhet poshtë si e pa pranueshme ose të refuzohet si e pa bazuar në ligj.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit me dt.11.11.2015 ka ushtruar përgjigjen në mbrojtje të AKP-së të cilës i ka bashkëngjitur Aktvendimin e trashëgimisë të dt.16.02.2015 të cilin e konteston e paditura. Njëherë i ka kundërshtuar të gjitha pretendimet e saj për faktin se, paditësi është i biri i të ndjerit O S i cili ishte pronarë i parcelës kadastrale nr. P-.. në vendin e quajtur B ZK D, K. Graçanicë me sip. 0,31.45 ha.

Me dt.09.07.2016, e paditura ka paraqitur kundërpërgjigje në të cilën ka mbështetur të gjitha pretendimet e theksuara në mbrojtjen në padi.

Me dt.25 korrik 2016, pala është përgjigjur në urdhërin e gjykatës përmes parashtresës duke bashkëngjitur: Kopjen e Aktvendimit të trashëgimisë, Kopjen e vërtetimit të lëshuar nga Komuna

e Graçanicës, Kopjen e vendimit e dt. 27 mars 2015 të lëshuar nga Komuna e Graçanicës me nr. 116/2015 dhe Kopjen e certifikatës së pronës.

Ndërsa, gjykata me urdhër i është drejtuar Drejtorisë për Kadastër në K e Graçanicës ashtu që duke vepruar sipas urdhërit me dt.19 gusht 2016, kjo drejtori ka dorëzuar historiatin e pronës P-.. ZK D.

Me dt.18.05.2023, gjykata ka mbajtur seancën gjyqore në të cilën ka marrë Aktvendim në të cilin është Aprovuar propozimi i përfaqësueses të paditurës që nga Komuna e Lipjanit në mënyrë zyrtare të kërkohet dosja e lëndës sa i përket procesit të eksproprijimit. Mirëpo, me dt.08.06.2023 është kthyer fletëdorëzimi me konstatimin se “urdhëri është adresuar gabimisht sepse, prona në fjalë i takon Komunës së Graçanicës”.

Me 31 maj 2023, i autorizuari i paditësit ka bërë rregullimin e padisë, ashtu që si palë të paditur ka paraqitur Agjencinë Kosovare të Privatizimit si dhe NSH “Kooperativa Buqësore Kosova” – Lipjan Njësia punuese “Shpeztaria“ -Lipjan.

Me dt.05 qershor 2023 gjykata lëshon urdhër për Drejtorinë e Financave dhe Pronës në Lipjan me të cilin kërkohet të parashtrij Dosjen e eksproprijimit të ngastrës kadastrale P-... në vendin e quajtur “B”ZK D, Komuna e Graçanicës në sip. Prej 0.31.45ha, të cili e përsërit me dt 21 qershor 2023 dhe vetëm sipas urdhërit të tretë, me dt. 10.08.2023 pranon një përgjigje të lëshuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa e K të Graçanicës.

Si në shqyrtimet gjyqësore në këtë çështje kontestimore, ashtu edhe në fjalën përfundimtare i autorizuari i palës paditëse ka mbetur në tërësi si në pretendimet në padi dhe në parashtrësën për rregullimin e padisë të dr.31.05.2023 dhe kërkoi që gjykata pas administrimit të gjitha provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar duke e detyruar të paditurën që menjëherë pas plotëfuqishmërisë të këtij aktgjykimi t’ia lirojnë pronën nga njerëzit dhe sendet dhe t’ia dorëzojnë në posedim parcelën e cila është objekt i këtij kontesti në kërcënim të përmbarimit me dhunë. Ndërsa, nëse kjo nuk është e mundur atëherë e paditura të detyrohet që paditësit t’ia dorëzojë në posedim dhe pronësi një paluajtshmëri tjetër që i përgjigjet me të gjitha karakteristika gjeodezike, pozitës dhe sipërfaqes me parcelën kontestuese si dhe ti paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore.

Paraardhësi i paditësit O Z S në vitin 1964 ka lidh kontratë me të paditurën në harmoni me ligjin për arondim i cili është aprovuar para këtij viti dhe i cili ligj ka pas për qëllim formimin e blloqeve të tokës bujqësore duke marrë si “Yrnek” (model) të ligjit për formimin e “kollvozeve dhe sollhozeve” – blloqeve të mëdha tokësore prandaj prej vitit 1964 e deri në vitin 1995 në fillim paraardhësi i paditësit pastaj paditësi në emër të rentës për çdo vit ka marrë nga 189 kg grurë ashtu siq është përshkruar në kontratën nr.. e lidhur dhe vazhduar me .. Prej këtij viti është pezulluar çdo kompenzim nga ana e palës së paditur dhe nuk ka pasur kurrfarë kompensimi lidhur me tokën të cilën akoma e shfrytëzojnë palët e paditura ndërsa, në vitin 01.04.2022 paditësi me faturën 2022 është obliguar që të paguaj tatim në pronë në shumë prej 587.63 euro. Gjithashtu me dt. 27.04.2023 ka pasuar fatura tjetër kështu që paditësi është detyruar që në emër të pagesës për tokën e shfrytëzuar të paguaj 1.015,28 €.

Kontrata e lidhur në mes paraardhësit të paditësit duke e zbatuar ligjin e arondacionit është lidh qysh ne vitin 1964 çka don të thot që nuk ka të bëjë me shpronësim përkatësisht eksproprijim dhe se komuna e Graçanicës në përgjigjen e parë me 18.08.2016 thekson se në bazë të kërkesës së kësaj gjykate me nr.5121/16 te dt. 04.08.2016 ku është kërkuar historiat i kësaj paluajtshmerie, ka dorëzuar kopjen e dokumenteve në bazë të të cilave janë bërë ndryshimet dhe certifikatat për ngastrën kontestuese. Tutje, ka shtuar se pas shqyrtimit në sistemin kadastral, librat kadastrale dhe vet lëndët, në baze të aktvendimit të trashëgimisë të marrë te noteri F T vërtetohet se, M S është trashëgimtar ligjor i tani të ndjerit O S i cili ishte edhe pronar i parcelës kontestuese-ngastra kadastrale P-. ZK D dhe se nga dt. 16.02.2015 kjo ngastër ka kaluar nga O S (tani i ndjer) në emër të djalit të tij M S. Ky ndryshim është regjistruar në librin për ndryshimin e pronësisë me nr. rendor 8, viti 2015.

Përfaqësuesi tutje ka shtuar se në këtë pronë nuk ka ndodhur asnjëherë shpronësimi kjo vërtetohet edhe nga përgjigja e Komunës se Graçanicës e cila nuk e argumentoi një gjë të tillë me asnjë provë vetëm sqaroi faktin që pronësia e cila është objekt i këtij kontesti është në emër të tani paditësit M(O) S .

Përfaqësuesi i paditësit konsideroi se duke gjetur se me të gjitha provat dëshmohej se paditësi është pronar i parcelës e cila është objekt i këtij kontesti, dhe se paditësi është shpallur trashëgimtar i paraardhësit të tij, i cili e kishte lidhur kontratën me të paditurën dhe se i njëjti si trashëgimtar i paditësit në vazhdimësi është ngarkuar edhe me pagesën e tatimit në pronë. Mbi këtë bazë edhe Kolegji i Ankesave e ka caktuar masën e sigurisë për parcelën kontestuese andaj, ka kërkuar që kërkesëpadia e tij të aprovohet si e bazuar.

***Përfaqësuesi i palës së paditur*** AKP si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë përgjigjes në padi në të cilën kërkesëpadinë e paditësit e ka kundërshtuar si të pa bazuar dhe te pa argumentuar. Kjo për faktin se paditësi i referohet vazhdimisht deklaratës duke theksuar se qysh nga vitin 1964 paraardhësit te paditësit i është marrë objekti lëndor mbi baze te Ligjit mbi arondimin. Në këtë situatë paditësi ka krijuar një paqartësi lidhur me pretendimet e tija ngase duke theksuar se toka lëndore mbi bazë te arondimit - Ligji mi arondimin, qe nënkupton ndërrimin e pronave pa e precizuar se a ka pas ndërrim pronash dhe nëse po, cila pronë i është dhënë pasi që kategorikisht e kundërshton se nuk ka pas eksproprijim te ngastrave. E paditura gjykatës i dorëzoi një kopje të regjistrit te pronave për eksproprijim si dhe certifikatat pronësorë përreth objektit lëndor me te cilat vërtetohet se këto ngastra evidentohen ne emër te paditurës. Kontrata e vitit 1995 nuk mund te konsiderohet si kontrate ligjërishit e plote dhe e saktë sepse, mungojnë të dhënat personale të qiradhënësit si dhe nënshkrimi i qiradhënësit, prandaj mungesa e emrit të plotë të qiradhënësit dhe nënshkrimit, kontratën e bënë të pa qartë, të pa plotë dhe si të tillë të pa vlefshme. Konsiderojmë se kopja e kontratës është bllanko fikse e cila është plotësuar kurse, në shkresat e lëndës nuk ka asgjë rreth asaj çka ka ndodhur prej vitin 1964-1995 sipas pretendimeve të paditësit a kemi të bëjmë me arondim apo kemi te bëjmë me eksproprijim. E paditura e kontestoi çështjen e bartjes dhe regjistrimit të pronës në librat kadastral si çështjen duke e kontestuar së pari kopjen e kontratës si të paqartë, si kontratë bllanko me të cilën ka vu në lajthim noterin e pastaj edhe Drejtorin e Kadastrit. Mbi bazën e të cekurave gjykatës i propozoi, qe nëse kemi te bëjmë me arondim gjykatës ti prezanton kontratën mbi ndërrimin dhe duke ju referuar kësaj gjendje faktike e

paditura i propozon trupit gjykues që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzon si të pa bazuar dhe të pa argumentuar.

### **Arsyetimi ligjor**

Kërkesë padia e paditësit aprovohet në tërësi si e bazuar .

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Kolegji gjykues i Dhomës së Posaçme, pas shqyrtimit të përgjithshëm të padisë, dokumenteve dhe provave të mbledhura gjatë gjithë procedurës me shkrim, administrimit të tyre një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën, vjen në përfundim se padia paditësve – kundër të paditurve duhet që aprovohet si e bazuar .

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)”*, ndërsa pika 3 parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.”*

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Mbrojtja e pronësisë parashihet me LMTHJP të vitit 1980 konkretisht me nenin 37 shprehimisht theksohet se *“Pronari mund të kërkojë me padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale. Pronari duhet të provojë se mbi sendin kthimin e të cilit e kërkon ka të drejtën e pronësisë dhe se sendi gjendet nën zotërimin faktik të të paditurit e drejta e paraqitjen së padisë nga paragrafi 1 i këtij neni nuk parashkruhet”*.

Në mes të palëve ndërgjyqësore nuk ishte kontestuese se kishin kontrata të shitblerjes të cilat ishin anuluar mirëpo, kontestuese ishte kthimi i sendeve (parcelave kontestuese si dhe kompensimit), pra ishin kontestuese dy rrethana që për gjykatën janë paraqitur vendimtare.

Gjykata pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të lartë cekura dhe deklarimeve të palëve ndërgjyqëse, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka vendosur si në dispozitiv

të këtij aktgjykimi, pasi që:

Në rastin konkret gjykata vlerëson se pronari i paluajtshmërisë ka të drejtë të kërkoj lirim të pronës së tij ndaj çdo personi tjetër i cili pa ndonjë bazë ligjore ose punë juridike hyn në shfrytëzim të pronës ose ndonjë pjese të saj. Për gjykatën nuk është kontestuese se paditësi tani i ndjeri O S ishte pronar i ngastrës kadastrale, për faktin se gjykata nga shqyrtimi i gjendjes së fakteve dhe provave të çështjes, në seancën e shqyrtimit kryesor ka gjetur se kërkesëpadija e paditësve –duhet aprovuar para se gjithash për shkakun se në bazë të kontratës me nr.. e lidhur me dt. . në mes të Organizatës shoqërore “Bujqësia” në Lipjan (DP Poljoprivreda) dhe bujkut O S paraardhës i paditësit M S, në të cilën kontratë janë paraparë obligimet e OSh “Bujqësia” që për çdo vit ta punoj tokën me mjete agroteknike dhe çdo mbledhje të të mirave më së voni deri më 1 dhjetor të vitit kalendarik ti dorëzoj pronarit shumën prej 189 kg grur ndërsa, pronarit O S ta dorëzoj në shfrytëzim parcelën e lartë cekur në afat prej 1 një viti duke u obliguar që mos ta pengoj OP-në në punët rreth të mbjellave por edhe mos ta tjetërsoi parcelën pa pëlqimin e OSh “Bujqësia” në afatin e paraparë me kontratë.

Në këtë rast nuk qëndron pretendimi i të paditurës se kontrata është e pavlefshme, se e njëjta është bllanko dhe e panënshkruar dhe nuk përfshin të dhëna të sakta për qiradhënësin dhe mbi këtë bazë statusi i pronësisë së paraardhësit të paditësit është i pa qartë.

E paditura në këtë mënyrë vie në kundërshtim me deklaratimet e veta kur gjykatës në plotësim të procedurës së provave i bashkangjet edhe regjistrin e parcelave në pronësi individuale të parapara për ndërtimin e objektit të shpeztarisë dhe në numrin rendor 27 të këtij regjistri ishte ranguar O (Z) S si pronar i parcelës me nr.. me nr. të fletës poseduese ., e në sipërfaqe prej 0,31.45 ha në vendin e quajtur B. Pra në këtë regjistër të dhënat për paraardhësin e paditësit janë identike me të cekurat në padi dhe në regjistër paraardhësi i paditësit identifikohet si pronar i ngastrës kontestuese por, ky regjistër nuk dihet nga kush është përpiluar apo me autorizim të kujt është bërë, nuk ka asnjë datë dhe nuk dihet e cilit vit është, në te evidentohet vetëm emri-mbiemri dhe nënshkrimi i referentit R M. Regjistri në fjalë përmban 39 pronar individual të tokave, parcelat e të cilëve përbëjnë një sipërfaqe prej 11,53.43 ha dhe atë në dy fshatra të ashtu quajtura B dhe D.

Ndërsa, regjistri tjetër të cilin e dorëzoi e paditura, i titulluar si “regjistër i prodhuesve individual –pronarët e parcelave të cilët propozohen për eksproprijim për shkak të zgjerimit të fermës së shpezëve“ ku në listën e 18 pronarëve të pronave, me numrin 6 rangohet pronari O (Z) S, për parcelën me nr.. në sipërfaqe prej 0,31.45 në vendin e quajtur B.

Edhe certifikata pronësore e lëshuar nga Zyra kadastrale në Graçanicë me dt. 20.07.2012 për pronën e palujtshme P-., në venin e quajtur B, në sipërfaqe prej 3145 m2 pronar evidenton si pronar paraardhësin e paditësit O (Z) S.

Kurse, Çertifikata pronësore e lëshuar nga Zyra Kadastrale në Graçanicë me dt. 16.02.2015 vërteton se kjo pronë ka kaluar nga O S në emër të M (O)S.

Çertifikatat pronësore të dorëzuara nga e paditura të cilat i referohen parcelave P-.. dhe P-.. evidentohen në emër të P.SH.Koperativa Bujqësore e Kosovës, për të cilat nuk e theksoi fare

mënyrën e bartjes tyre në emër të Kooperativës të cilat për gjykatës nuk kishin ndonjë relevancë ndërsa, parcela P-.. objekt i këtij kontesti sipas numrit gjendet në mesin e këtyre dy parcelavetë cekura më lartë .

Andaj, pretendimet e të paditurës Gjykata nuk i mori për bazë për faktin se kundërshtimet e saj nuk u mbështetën në asnjë provë të vetme për të vërtetuar se nga paraardhësi i paditësit, ishte ekspropriuar apo shpronësuar me vendim, parcela kontestuesi dhe ate për interes të ndërtimit dhe zgjerimit të fermës së shpezëve.

E drejta e pronësisë është një e drejtë e karakterit absolut që vepron ndaj të gjithë personave, pra të gjithë personat e tjerë janë të obliguar ta respektojnë të drejtën e pronësisë së pronarit të tokës por, si e drejtë i takon vetëm pronarit të tokës dhe rrjedhimisht nga kjo gjykata vlerëson se paditësi figuron si pronar i tokës, gjë që vërtetohet edhe nga provat e administruara dhe nga ky fakt gjen se takon e drejta për të kërkuar kthimin e pronës.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit por, të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje, pasi që gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e të paditurës, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla nuk u morën për bazë .

Përfaqësuesi i paditësit në shqyrtim gjyqësor dhe në fjalën e tij përfundimtare i kërkoi shpenzimet e procedurës por nuk e përcaktoi shumën e tyre sipas tarifës së Odës së Avokatëve andja, gjykata nuk e obligoi të paditurën me pagesën e shpenzimeve procedurale.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenin 54.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Pala paditëse e ka paguar taksën gjyqësore për padi.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**Hajrie Shala, Gjyqtare kryesuese** \_\_\_\_\_

**Manusha Karaqi, Gjyqtare** \_\_\_\_\_

**Sylejman Shumolli, Gjyqtar** \_\_\_\_\_